




|  |   |
|--|---|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO                          |   |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |   |
| Dep.<br>Dep. <u>2-D/DPK</u>  | Nr. Prot.<br>Bil. Prot. <u>01-2523/13</u> |
| Nr. ifaq.<br>Broj. stranica <u>02</u>  | Data<br>Datum <u>26-08-2013</u>           |
| Nr. pages  | PRISHTINE                                 |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.08.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-465/13, për zyrtarin e lartë z. Fuat Pallaska, Anëtar i Bordit në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave Çabрати -Gjakovë, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Pas identifikimit të rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-465/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Fuat Pallaska, Anëtar i Bordit në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave Çabрати - Gjakovë, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pasi që ushtron pozitën e personit të autorizuar në Kompaninë private "ENERGY AUDIT-CO-sh.p.k.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.04.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Fuat Pallaska, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, sipas procedurës është organizuar takimi me z. Pallaska me datën 08.05.2013, dhe i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari në fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e Anëtarit të Bordit në Kompaninë

Regjionale të Mbeturinave Çabрати në Gjakovë dhe është i regjistruar si person i autorizuar dhe pronare në biznesin private "ENERGY AUDIT-CO-sh.p.k.

Gjatë takimit zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së dhe është zotuar se do të mundohet që në afat sa me të shpejtë do të bëjë ndryshimet dhe do të japë dorëheqje nga pozita e personit të autorizuar dhe do ta shmangë çfarëdo situatë që mundë të shkaktoj konflikt të interesit.

Pas këtij takimi zyrtari i lartë z. Fuat Pallaska, ka sjellë në Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se është tërhequr nga të qenurit person i autorizuar i Kompaninë në fjalë.

Duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë z. Fuat Pallaska, konstatohet se : zyrtari i lartë z. Fuat Pallaska, Anëtar i Bordit në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave Çabрати-Gjakovë, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

